



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:294065
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05650331

A.nr.3112/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses, A.M., nga ..., në adresën ..., kundër të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme- Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë- Komisioni për Vendosje, për shkak të anulimit të aktvendimit KV.nr.4842/2021, të datës 19.11.2021, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palës paditëse, ekspertit të komunikacionit dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 15.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet kërkesëpadia e paditëses, ..., nga ... si e bazuar.

II. Anulohet vendimi me numër KV. Nr.4842/2021, i datës 19.11.2021, i të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë – Komisioni për Vendosje, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Paditësja me padi të datës 29.12.2021 ka kërkuar nga gjykata të miratohet kërkesëpadia si bazuar dhe të detyrohet e paditura të anulohet vendimin e datës 19.11.2021 dhe shqiptimin e dënuar me gjobë prej 200 euro.

Ndërsa, seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se, kërkon nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar dhe të anulohet vendimi kontestues i të paditurës i me numër KV. Nr.4842/2021, i datës 19.11.2021, i të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në

Prishtinë – Komisioni për Vendosje si dhe lirimi nga shqiptimi i gjobes prej 200.00 Euro, kjo shumë pasi qe eshte paguar, të kthehet. Ndersa sa i perket ekspertizes kam verejtje, ngase eshte e manget dhe nuk eshte cekur në ekspertiz ashtu sic është kërkuar, që detyrë e ekspertit të jetë se, a ka pasur kontakt në mes të veturës A dhe B.

E paditura në përgjigjen në padi, të parashtruar në gjykatë me datë 22.08.2023, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke theksuar se vendimi kontestues është i bazuar në ligj, kurse pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë dhe nuk janë të bazuara në dispozita ligjore sepse në të dy shkallët në procedurën kundërvajtëse është vërtetuar me prova të pa kontestueshme se i njëjti ka kryer kundërvajtjen, prandaj, i propozon gjykatës që të refuzojë kërkesëpadinë si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 15.04.2024, ka administruar provat relevante: fletëparaqitja e dt.16.10.2021; raporti i aksidentit i dt.06.10.2021 numër 2021-AR-2793; shikohen fotot; Vërtetimi 25.10.2021; Ankesa e dt.24.10.2021; vendimi 19.12.2021 numër 4842/2021; policia e sigurimit 15.01.2021; deklarata numër te rastit 21-2793 i dt.06.10.2021; Kopja e Patentë shoferit e dt. 11.03.2021; deklarata e dt.11.06.2022; kopja e patentë shoferit te paditëses ; kopja e librezës se veturës 01335-NN; Ekspertiza e aksidentit e dt.02.03.2024.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, komform Nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) – Ligji Nr. 03/L-202, gjykata, në bazë të provave të administruara dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Organi i shkallës së parë, Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Prishtinë, me fletëparaqitjen me numër SHQ5000118451, të datës 16.10.2021, ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje paditësen, me arsyen se i njëjti, duke drejtuar automjetin e tipit “VW Golf”, viti i prodhimit 2007, ngjyrë e zezë, me targa 01-355-NM, tek rreth rrotullimi në afërsi të stacionit të autobusëve në Prishtinë, rreth orës 13.37 min, ka shkaktuar kundërvajtje nga neni 41 paragrafi 3 dhe neni 255, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ku si pasojë e mos marrjes së veprimit në mënyrë të duhur, ka shkaktuar aksident trafiku me dëme materiale.

Me vendimin e të paditurës, MPB-PK-DPP, si shkallë e dytë, me numër KV.nr.4842/2021, të datës 19.11.2021, është refuzuar kundërshtimi, i tani paditëses, si i pa bazuar dhe është vërtetuar vendimi i goditur si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

I pakënaqur me këtë vendim, paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë: 29.12.2021, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij.

Nga vendimi kontestuar del se ajo përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e saj. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit ligji, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se, “Paneli i komisionit për vendosje vlerëson se vendimi i marr në shkallë të parë nga zyrtaret policor në vendin e ngjarjes, gjatë zhvillimit të procedurës kundërvajtës, në tersi ka qenë siç përcaktojnë dispozitat e procedurës kundërvajtëse, përkatësisht, nuk është bërë zbatimi i gabuar i dispozitave të drejtës materiale në dëmin e kundërvajtësit. Kurse sa i përket lartësisë së dënimit të shqiptuar paneli konsideron se dënimi i shqiptuar është i bazuar në dispozitat ligjore dhe se kundërvajtësi i është shqiptar dënimi që parasheh ligji për kundërvajtjen e kryer.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të padisë, pati parasysh Neni 64 paragrafin 1 të Ligjit për Kundërvajtje ku përcaktohet se: “Kundër vendimit përfundimtar për kundërvajtje, të cilën e ka nxjerrë organi i kundërvajtjes, mund të paraqitet padia për zhvillimin e kontestit administrativ. Padinë mund ta paraqes personi (fizik ose juridik), ndaj të cilit i është shqiptuar sanksioni, përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht mbrojtësi, i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij, si dhe pronari i sendit të konfiskuar/marrë dhe në procedurën e kundërvajtjes”, si dhe paragrafi 4 i po të njëjtit nen ku përcaktohet se, Gjykata kompetente që të vendosë për konfliktin administrativ procedurën e mbrojtjes gjyqësore e zhvillon sipas Ligjit për Konfliktet Administrative” Gjykata gjeti se, fakt kontestues në këtë çështje është vlerësimi i gjendjes faktike, rrjedhimisht vendimi i zyrtarëve policorë, në këtë rast, të cilët kanë nxjerrë aktin, si shkallë e parë.

Gjykata në të mirë të konstatimit të gjendjes faktik me kërkesën e palës paditëse me aktvendimin A.nr.3112/2021 të datës 26.10.2023, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e komunikacionit e cila i është besuar Ekspertit të komunikacionit

Me datën 02.03.2024, ka përpiluar Raportin e Ekspertizës, të dorëzuar në gjykatë, dhe gjykata po ashtu ka ftuar ekspertin e komunikacionit të deklarohet lidhur me ekspertizën në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata me rastin e vlerësimit të provave të administruara të cilat gjenden në shkresat e lëndës iu referua ekspertizës së datës 02.03.2024 dhe konstatoi se, “duke ju referuar raportit të policisë, dëmtimeve të votuarve dhe pozitive përfundimtare të veturës A dhe B , rezulton se shpejtësia e lëvizjes ka qenë e vogël në norma të lejuara për pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti i komunikacionit; Kyçja e shoferit të veturës në rreth rrotullim nga rruga Tirana, pika e kontaktit e paraqitur nga policia e Kosovës dhe dëmtimet e veturave nuk korrespondojnë ndemjet veti, sepse pika e kontaktit në Rrugën Tirana janë afër ; Gjithashtu Rruga Tirana është afër pikës së kontaktit të caktuar nga policia e Kosovës , është pamundur shoferi i veturës A të kyçet në rrethin e tret dhe pastaj në të dytin dhe para momentit të aksidentit të kyçet edhe në shiritin e tret siç është cekur në raportin e policisë; të dhënat e policisë që janë të vendosura në rubrika në skaje të raportit dhe që plotësohen me shifra nga ana e zyrtarëve policore, nuk përputhen me rastin e aksidentit të ndodhur; Rubrika 13 e plotësuar në raportin e policisë me numër 9, ka kuptim që veprimet e automjetit para ndeshjes kanë qenë hyrje në trafik (fig 8) ndërsa në raportin narrativ të policisë së Kosovës, thuhet se shoferja e veturës A para momentit të aksidentit ka qenë duke lëvizur në rrugën Tirana, e që nga kjo vjen në përfundim që ë gjithë pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të përmbahen rregullave të trafikikut rrugor për lëvizje në rrugë. Lëshimet në këtë aksident janë në anën e dy pjesëmarrësve (shoferit të veturës A dhe B) të cilët nuk kanë mbajtur distancë të sigurt anësorë gjatë lëvizjes në shiritat qarkullues në drejtim të njëjtë. Kësaj ekspertize gjykata i’a falë besimin dhe e vlerësoj si një ekspertize profesionale, konçize, të argumentuar qartë dhe me metoda bashkëkohore, dhe njëherësh konstatoj se organi i shkallës së dytë kur ka vendosur në lidhje me kundërshtimin e tani paditësit, përsëri nuk janë zbatuar drejtë dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, respektivisht të nenit 41 paragrafi 3 dhe nenin 255 paragrafi 1 të Ligjit 05/1-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor – me cilin ju është shqiptuar dënimi me gjobë prej 200 euro, por vetëm ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë.

Andaj, gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike, të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në

ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKS-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE
A.nr.3112/2021 data 15.04.2024

Gjyqtare
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.